



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 10 janar 2018
Nr. ref.:RK 1183/18

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI74/17

Parashtrues

Lorenc Kolgjera

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Themelore në
Prizren, P. nr. 331/2014, të 29 majit 2017**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Lorenc Kolgjera (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), nga fshati Breg-Drin, komuna e Prizrenit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren, P. nr. 331/2014, të 29 majit 2017.
3. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të mos zbulohet identiteti i tij me arsyetimin se: *“jam pensionist, ish-punëtor i arsimit dhe nuk jam i interesuar që të publikohen të dhënat e mia”*.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P. nr. 331/2014, të 29 majit 2017 dhe zvarritja e supozuar e procedurave në Gjykatën e Apelit.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 20 qershor 2017, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 30 qershor 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.
8. Më 24 gusht 2017, parashtruesi i kërkesës ishte njoftuar për regjistrimin e kërkesës dhe atij i ishte kërkuar që ta plotësojë dhe ta qartësojë kërkesën e tij në pajtim me rregullin 29 të Rregullores së punës.
9. Më 6 shtator 2017, parashtruesi i kërkesës dorëzoi formularin e plotësuar.
10. Më 28 shtator 2017, Gjykata u dorëzoi nga një kopje të kërkesës Gjykatës Themelore në Prizren dhe Gjykatës së Apelit.
11. Më 5 dhjetor 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Nga dokumentet e dorëzuara, rezulton se më 28 prill 2014, KRU “Radoniqi-Dukagjini” Sh. A. në Gjakovë kishte paraqitur propozim përmbarimi kundër parashtruesit të kërkesës tek Përmbaruesi Privat për territorin e Prizrenit, që në bazë të ‘dokumenteve të besueshme’ të obligohet parashtruesi i kërkesës që në

afat prej 7 (shtatë) ditësh ta paguajë borxhin prej 1332.27 € për shërbime të furnizimit me ujë për ujitje.

13. Më 29 shtator 2014, Përmbaruesi Privat kishte urdhëruar lejimin e propozimit për përmbarim kurse parashtruesi i kërkesës ishte njoftuar për të drejtën e tij që në afat prej 7 (shtatë) ditësh të ankohet në Gjykatën Themelore në Prizren.
14. Më 18 maj 2017, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur prapësim kundër urdhrit për lejim të propozimit për përmbarim.
15. Më 29 maj 2017, Gjykata Themelore në Prizren (Aktvendimi P. nr. 331/2014) prapësimin e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës e kishte hedhur poshtë si të paafatshëm. Gjykata Themelore, duke iu referuar nenit 73 të LPP-së, konstatoi se prapësimi i parashtruesit të kërkesës ishte i paafatshëm sepse ishte paraqitur pas afatit ligjor 7 (shtatë) ditor.
16. Më 13 qershor 2017, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se prona për të cilën kërkohet borxhi iu takon palëve të treta dhe se për këtë arsye ai nuk mund të paditet sepse i mungon legjitimiteti pasiv.
18. Parashtruesi i kërkesës më tej shton se: *“pala pretendon se qëllimisht si nga KRU Radoniqi ashtu edhe nga Përmbaruesi Privat dhe gjykata iu është bërë shkelje e të drejtës së tij ligjore, si në ligjshmëri – barazia para ligjit ashtu edhe e drejta e tij kushtetuese të cilat presim që të vlerësohen drejtë.”*
19. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që: *“të vërtetohet se Gjykata, Përmbaruesi Privat kanë bërë shkelje ligjore ... KRU Radoniqi-Dukagjini shkeljen e të drejtave të tij-debitorit ku pa prova dhe argumente e kanë fut si debitor.”*

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
21. Gjykata i referohet nenit 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

22. Gjykata po ashtu i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit, që parasheh:

“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

23. Gjykata merr parasysh rregullin 36 (1) (b) [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, që specifikon:

“Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë nëse:

(...)

(b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar.”

24. Gjykata konsideron se parashtruesi ka të drejtë mbrojtjeje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; porse, bazuar në parimin e subsidiaritetit, parashtruesi është i obliguar që t'i shterojë të gjitha mjetet juridike në procedurë të rregullt gjyqësore para se t'i drejtohet Gjykatës, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës.
25. Gjykata vëren se, në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës është ankuar në Gjykatën e Apelit dhe se akoma nuk ka ndonjë vendim në atë procedurë; çka nënkupton, se procedura sipas ankesës së parashtruesit në Gjykatën e Apelit është në zhvillim e sipër. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit është e parakohshme.
26. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se gjykatat e rregullta janë të pavarura në ushtrimin e kompetencave ligjore dhe është obligim dhe prerogativë e tyre kushtetuese për t'i interpretuar çështjet e fakteve dhe të ligjit, të cilat janë relevante për rastet e shqyrtuara nga to. (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: Rasti nr. KI151/13 parashtruese *Sitkije Morina*, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 176/2012, të 18 prillit 2013, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 dhjetorit 2013, paragrafi 33).
27. Gjykata po ashtu vëren se parashtruesi i kërkesës, në mënyrë të nënkuptuar, dëshiron të lirohet nga obligimi për t'i shteruar të gjitha mjetet juridike, mirëpo, ai nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se mjetet juridike në dispozicion të tij janë të papërshtatshme dhe joefektive, me ç'rast ai do të lirohej nga rregulli për shterimin e mjeteve juridike (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: Rasti nr. KI116/14, parashtrues *Fadil Selmanaj*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AA nr. 294/2013, të 4 shkurtit 2014, Aktvendim për papranueshmëri, i 26 janarit 2015, paragrafët 45 dhe 46 dhe referencat e cituara në atë vendim).
28. Arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'u ofrohet autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësia për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive juridike kundër

shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (shih rastin KI41/09, parashtrues *Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K., Prishtinë*, Aktvendim për papranueshmëri i 21 janarit 2010, dhe *mutatis mutandis*, shih rastin GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës*, Nr. 25803/94, Vendimi i GJEDNJ-së, i 28 korrikut 1999).

29. Parimi i subsidiaritetit përcakton që parashtruesi i kërkesës t'i shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, administrative ose gjyqësore, në mënyrë që të parandalohen shkeljet kushtetuese apo, nëse ka, të korrigjohet shkelja e të drejtave themelore (Po aty, rasti nr. KI151/13, parashtruese *Sitkije Morina*, dhe referencat e përmendura në atë vendim, paragrafi 35).
30. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet efektive siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, parashikohet me nenin 47 të Ligjit, dhe siç specifikohet më tej me rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës.

Kërkesa për moszbulim të identitetit

31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 29 (6) [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës, që specifikon:

[...]

“(6) Pala që parashtron kërkesë mund të kërkojë që identiteti i tij ose i saj të mos zbulohet publikisht dhe të paraqesë arsyet për këtë kërkesë. Gjykata mund të aprovojë kërkesën nëse vërteton se arsyet janë të bazuara mirë.”

32. Për sa i përket kërkesës së parashtruesit për moszbulim të identitetit, Gjykata vëren se arsyetimi se: *“jam pensionist, ish-punëtor i arsimit dhe nuk jam i interesuar që të publikohen të dhënat e mia”*, nuk është bazë për miratim të kësaj kërkesë (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: rasti nr. KI22/13, parashtrues *Sokol Mushkolaj*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 164/2012, të 5 dhjetorit 2012, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 korrikut 2013, paragrafi 33).
33. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit për moszbulim të identitetit duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës, më 5 dhjetor 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

